



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i zbatimit të

Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime
kapitale
për vitin 2025

Janar, 2026

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	5
Përmbledhje ekzekutive.....	5
Përshkrimi i Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale.....	6
Përmbledhje e vlerësimit të projekteve për financim	7
Përmbledhje e procesit të aplikimit	7
Përmbledhje e procesit të përzgjedhjes.....	9
Projektet në vazhdim nga viti 2024	11
Ecuria e zbatimit të projekteve kapitale në vitin 2025	12
Pasqyra e projekteve kapitale në zbatim gjatë vitit 2025	12
Shpërndarja financiare e projekteve kapitale sipas rajoneve zhvillimore	13
Statusi i përgjithshëm i zbatimit të projekteve kapitale	16
Arsyet e mosrealizimit	18
Projektet që vazhdojnë realizimin në vitin 2026.....	19
Përfundimi	21
ANEKS 1 Rajoni zhvillimor: Qendër	22
ANEKS 2 Rajoni zhvillimor: Veri	25
ANEKS 3 Rajoni zhvillimor: Perëndim	27
ANEKS 4 Rajoni zhvillimor: Jug.....	30
ANEKS 5 Rajoni zhvillimor: Jug-lindje	36
ANEKS 6 Rajoni zhvillimor: Lindje	39
ANEKS 7 Rajoni zhvillimor: Jug-perëndim	43

Lista e tabelave

Tabela 1: Projektet e përzgjedhura në vitin 2025 sipas viteve të financimit dhe statusit të projekteve	9
Tabela 2: Projektet dyvjeçare në zbatim sipas PZHR 2024 për periudhën 2024–2025.....	11
Tabela 3: Pasqyra e projekteve kapitale në zbatim gjatë vitit 2025 sipas rajoneve zhvillimore	12
Tabela 4: Shpërndarja e financimeve të projekteve kapitale sipas rajoneve zhvillimore (2025)	13
Tabela 5: Statusi i zbatimit dhe progresi financiar i projekteve kapitale në vitin 2025	16
Tabela 6: Analiza e faktorëve pengues në realizimin e projekteve kapitale.....	19
Tabela 7: Projektet kapitale që vazhdojnë realizimin e në vitin 2026	20
Tabela 8: Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë	22
Tabela 9: Ndërtimi i tregut të gjelbërt.....	23
Tabela 10: Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik.....	24
Tabela 11: Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë	25
Tabela 12: Udhë e Gurit	26
Tabela 13: Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarë ...	27
Tabela 14: Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II.....	28
Tabela 15: Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan	29
Tabela 16: Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve “ESNAF”	30
Tabela 17: Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit.....	31
Tabela 18: Renovimi i “Urës së Tranzitit” dhe rregullimi i shtratit të lumit “Tophulla” - Segmenti 2.2.....	32
Tabela 19: Ndërtimi i shtëpisë së kulturës me shumë qëllime	33
Tabela 20: Ndërtimi i Shtëpise së Kulturës - Faza II	34
Tabela 21: Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosavë	35
Tabela 22: Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh.....	36
Tabela 23: Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - Komuna e Shtimës (Faza II).....	37
Tabela 24: Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustënik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë.....	38
Tabela 25: Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër	39
Tabela 26: Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot.....	40
Tabela 27: Parku i Aventurave	41
Tabela 28: Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit	42
Tabela 29: Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit	43
Tabela 30: Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve	44
Tabela 31: Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut.....	45

Lista e figurave

Figura 1: Pjesëmarrja e projekt-propozimeve sipas rajoneve zhvillimore në kuadër të Masës 1	9
Figura 2: Pjesëmarrja e projekteve sipas rajoneve zhvillimore në kuadër të Masës 1 (2025)	10
Figura 3: Shpërndarja e financimeve për projektet kapitale sipas rajoneve zhvillimore, në euro (2025)	15

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHR	Programi për Zhvillim Rajonal
DZHMP	Divizioni për Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve të Zhvillimit Rajonal
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
M.M.	Memorandum Mirëkuptimi
RZH	Rajoni zhvillimor



Hyrje

Ky raport paraqet zbatimin e investimeve kapitale në komuna gjatë vitit 2025, në kuadër të Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale, e cila është përcaktuar me miratimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027. Kjo masë synon të forcojë kapacitetet zhvillimore të komunave përmes financimit të projekteve strategjike që kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve publike dhe kushteve të përgjithshme të jetesës për qytetarët.

Në raport përfshihen edhe projektet që vazhdojnë nga viti 2024, të cilat janë aprovuar në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal, si dhe projekte të reja të përzgjedhura gjatë vitit 2025, bazuar në prioritetet zhvillimore dhe nevojat konkrete të komunave.

Raporti është përgatitur nga institucioni përgjegjës (MZHR) për zbatimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe bazohet në të dhënat zyrtare të raportuara mbi ecurinë fizike dhe financiare të projekteve.

Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi ecurinë e zbatimit të projekteve, shpërndarjen e fondeve ndërmjet komunave dhe rajoneve zhvillimore, si dhe progresin e arritur në zhvillimin socio-ekonomik. Njëkohësisht, raporti shërben si bazë informative për vlerësimin e ndikimit të investimeve kapitale dhe për planifikimin e ndërhyrjeve të ardhshme në kuadër të zhvillimit rajonal të balancuar.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2025, investimet kapitale në komuna janë zbatuar në kuadër të Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale, e cila rrjedh nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027. Në kuadër të kësaj mase janë zbatuar edhe projektet dyvjeçare të aprovuara në vitin 2024 dhe që vazhdojnë realizimin në vitin 2025, ashtu edhe projektet e reja të përzgjedhura gjatë këtij viti, në përputhje me prioritetet dhe nevojat zhvillimore të komunave.

Gjatë vitit 2025 janë përzgjedhur gjithsej 16 projekte të reja, prej të cilave 6 projekte njëvjeçare dhe 10 projekte dyvjeçare, me një vlerë totale investimi prej 3,582,691.27 euro. Nga kjo shumë, 1,882,691.27 euro janë planifikuar për financim gjatë vitit 2025, ndërsa 1,700,000.00 euro për vitin 2026.

Projektet e realizuara dhe në zbatim kanë kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës publike, zhvillimin e turizmit dhe mbështetjen e trashëgimisë kulturore, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik në nivel lokal dhe rajonal. Shpërndarja e investimeve ndërmjet rajoneve zhvillimore ka ndikuar në uljen e pabarazive rajonale dhe në forcimin e zhvillimit të barabartë territorial.

Kjo përmbledhje ekzekutive paraqet rezultatet kryesore të zbatimit të Masës 1 gjatë vitit 2025 dhe shërben si bazë orientuese për analizën e detajuar të paraqitur në kapitujt vijues të raportit.

Përshkrimi i Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale

Qëllimi i Masës 1

Masa 1 synon uljen e pabarazive mes komunave dhe rajoneve zhvillimore përmes përmirësimit të infrastrukturës socio-ekonomike, eliminimit të mungesës së stimujve për ndërmarrjet, si dhe uljen e migrimit të brendshëm të të rinjve dhe bizneseve nga rajonet më pak të zhvilluara drejt qendrave më të mëdha. Kjo masë mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës përmes politikave publike efektive.

Objektivat e Masës 1

- Përmirësimi i infrastrukturës socio-ekonomike dhe dixhitalizimi i proceseve në rajonet më pak të zhvilluara, për të krijuar kushte më të mira jetese dhe zhvillimi ekonomik.
- Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës përmes projekteve në fushën socio-ekonomike, dixhitale, turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Nën-masat e Masës 1

- ***Nën Masa 1.1: Investime në infrastrukturë publike komunale***
Investime në infrastrukturën publike që përmirësojnë shërbimet bazë dhe krijojnë kushte për zhvillim ekonomik në rajonet më pak të zhvilluara.
- ***Nën Masa 1.2: Investime në infrastrukturë dhe dixhitalizim***
Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe dixhitalizimi i proceseve lokale për të lehtësuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset.
- ***Nën Masa 1.3: Projekte për zhvillim të qëndrueshëm, turizëm dhe trashëgimi kulturore***

Mbështetje e projekteve që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm, turizmin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik dhe uljen e migrimit të brendshëm.

Lidhja me masat e tjera

Masa 1 ndërlidhet me masat që synojnë përmirësimin e kapaciteteve rajonale, duke krijuar një bazë të fortë për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në rajonet zhvillimore.

Përfituesit

- Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës,
- Institucionet lokale, përfshirë Qendrat për Zhvillim Rajonal dhe institucionet e tjera në nivel lokal,
- Organizatat e Shoqërisë Civile dhe organizatat private që operojnë në fushën e zhvillimit socio-ekonomik, dixhital, turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Kushtet e përgjithshme

Komunat dhe përfituesit e tjerë potencialë duhet të dorëzojnë projekt-propozime që janë në përputhje me prioritetet e programit vjetor. Shpërndarja e fondeve do të bazohet në vlerësimin e potencialit rajonal dhe nevojave të përfituesve.

Përmbledhje e vlerësimit të projekteve për financim

Ky kapitull ofron një pasqyrë të përgjithshme të procesit të vlerësimit të projekteve për financim në kuadër të thirrjes publike për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025, Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale. Në këtë kuadër paraqitet procesi i aplikimit, niveli i pjesëmarrjes së komunave, shpërndarja e projekt-propozimeve sipas rajoneve zhvillimore, si dhe procesi i përzgjedhjes së projekteve fituese, në bazë të kriterëve të përcaktuara.

Përmbledhje e procesit të aplikimit

Gjatë fazës së aplikimit, në kuadër të thirrjes publike për Masën 1, kanë aplikuar gjithsej 26 komuna të Republikës së Kosovës, duke dorëzuar 37 projekt-propozime. Projektet e paraqitura janë shpërndarë në shtatë rajone zhvillimore, duke reflektuar interes të gjerë të

komunave për përfitim nga fondet për investime kapitale dhe adresim të nevojave zhvillimore lokale.

Rajoni zhvillimor Qendër shënon nivelin të lartë të pjesëmarrjes, me gjithsej shtatë projekt-propozime të paraqitura nga disa komuna. Në këtë rajon vërehet aplikim i shumëfishtë nga komuna e Drenasit, e cila ka aplikuar me katër projekt-propozime, çka dëshmon për nevoja të shtuara zhvillimore dhe angazhim të lartë institucional në përgatitjen e projekteve.

Rajoni zhvillimor Veri paraqitet me një pjesëmarrje të qëndrueshme, me gjithsej gjashtë projekt-propozime, të fokusuara kryesisht në infrastrukturën publike, hapësira rekreative dhe shërbime për komunitetin. Në këtë rajon, komuna e Zubin Potokut ka aplikuar me tre projekt-propozime.

Nga rajonin zhvillimor Perëndim janë dorëzuar gjithsej katër projekt-propozime, me fokus kryesor në përmirësimin e infrastrukturës bazë dhe rritjen e lidhshmërisë. Në këtë rajon, komuna e Klinës ka aplikuar me dy projekt-propozime.

Rajoni zhvillimor Jug shënon një nivel të moderuar pjesëmarrjeje me pesë projekt-propozime, të orientuara kryesisht drejt zhvillimit urban, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit, duke reflektuar specifikat dhe prioritetet zhvillimore të këtij rajoni. Komuna e Prizrenit ka aplikuar me tre projekt-propozime.


Në rajonin zhvillimor Juglindje janë paraqitur gjithsej katër projekt-propozime, me një shpërndarje relativisht të balancuar ndërmjet komunave. Projektet janë kryesisht të fokusuara në zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe përmirësimin e hapësirave publike.

Rajoni zhvillimor Lindje paraqet një pjesëmarrje relativisht të lartë me gjithsej shtatë projekt-propozime që adresojnë nevoja urbane, kulturore dhe mjedisore. Në këtë rajon, komuna e Kllokotit ka aplikuar me dy projekt-propozime.

Rajoni zhvillimor Jugperëndim ka shënuar një pjesëmarrje të moderuar me gjithsej katër projekt-propozime, të fokusuara kryesisht në investime në infrastrukturë, trashëgimi kulturore dhe ofrim të shërbimeve bazë për komunitetin. Komuna e Gjakovës ka aplikuar me dy projekt-propozime.

Shpërndarja e projekt-propozimeve sipas rajoneve zhvillimore paraqitet në Figurën 1 dhe pasqyron interes të gjerë territorial për financim në kuadër të Masës 1.

Figura 1: Pjesëmarrja e projekt-propozimeve sipas rajoneve zhvillimore në kuadër të Masës 1



Përmbledhje e procesit të përzgjedhjes

Procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim është zhvilluar në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe aktet përkatëse nënligjore. Vlerësimi i projekt-propozimeve është bazuar në analiza teknike dhe financiare, duke marrë parasysh relevancën e projektit me objektivat e Masës 1, ndikimin socio-ekonomik të pritshëm, qëndrueshmërinë e projektit, gatishmërinë për zbatim dhe kapacitetet institucionale të komunave aplikuese.

Nga gjithsej 37 projekt-propozime të pranuar, janë përzgjedhur 16 projekte të reja për financim në vitin 2025. Prej tyre, gjashtë (6) projekte janë të karakterit njëvjeçar, ndërsa dhjetë (10) projekte janë të planifikuara për zbatim dyvjeçar gjatë periudhës 2025–2026. Vlera totale e investimeve për këto projekte arrin në 3,582,691.27 euro, nga të cilat 1,882,691.27 euro janë planifikuar për financim gjatë vitit 2025, ndërsa 1,700,000.00 euro gjatë vitit 2026.


Tabela 1: Projektet e përzgjedhura në vitin 2025 sipas viteve të financimit dhe statusit të projekteve

Nr.	Komuna	Emri i projektit	Statusi	Vlera 2025 (€)	Vlera 2026 (€)	Totali (€)
1	Dragash	Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosavë	Njëvjeçar	130,000.00	–	130,000.00
2	Mamusha	Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës - Faza II	Njëvjeçar	225,000.00	–	225,000.00
3	Hani i Elezit	Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat përreth	Njëvjeçar	90,121.95	–	90,121.95
4	Klinë	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan	Njëvjeçar	100,000.00	–	100,000.00
5	Zubin Potok	Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek liqeni i Zubin Potokut	Njëvjeçar	80,000.00	–	80,000.00

6	Kamenicë	Parku i Aventurave	Njëvjeçar	50,000.00	-	50,000.00
7	Prizren	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalane e Prizrenit	Dyvjëçar	150,000.00	200,000.00	350,000.00
8	Shtime	Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të	Dyvjëçar	150,000.00	272,000.00	422,000.00
9	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë	Dyvjëçar	150,000.00	200,000.00	350,000.00
10	Podujevë	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik	Dyvjëçar	50,000.00	200,000.00	250,000.00
11	Ferizaj	Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh	Dyvjëçar	100,000.00	200,000.00	300,000.00
12	Gjakovë	Renovimi i objektit të NPL "Stacionit të Autobusëve" - Gjakovë	Dyvjëçar	100,000.00	150,000.00	250,000.00
13	Vushtrri	Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës	Dyvjëçar	100,000.00	50,000.00	150,000.00
14	Gjilan	Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit	Dyvjëçar	219,569.32	200,000.00	419,569.32
15	Junik	Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik	Dyvjëçar	90,000.00	128,000.00	218,000.00
16	Rahovec	Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve	Dyvjëçar	98,000.00	100,000.00	198,000.00
Totali i përgjithshëm:				1,882,691.27	1,700,000.00	3,582,691.27

Projektet e përzgjedhura synojnë forcimin e infrastrukturës publike, zhvillimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në komunat përfituese. Dominimi i projekteve dyvjëçare reflekton orientimin drejt ndërhyrjeve kapitale me ndikim afatmesëm dhe të qëndrueshëm në zhvillimin lokal dhe rajonal. Shpërndarja e financimeve të projekteve për vitin 2025 sipas rajoneve zhvillimore paraqitet në Figurën 2.

Figura 2: Pjesëmarrja e projekteve sipas rajoneve zhvillimore në kuadër të Masës 1 (2025)



Siç vërehet nga të dhënat, rajonet zhvillimore Juglindje dhe Jug kanë përfituar pjesën më të madhe të financimeve për këtë vit, ndërsa rajonet Perëndim dhe Qendër kanë një pjesëmarrje më të ulët në financim, çka reflekton shpërndarjen e projekteve të përzgjedhura dhe nivelin e përfitimit rajonal nga fondet e alokuara.

Projektet në vazhdim nga viti 2024

Gjatë vitit 2024, disa projekte u aprovuan si projekte dyvjeçare në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal (2024) dhe vazhduan zbatimin në vitin 2025. Këto projekte sigurojnë vazhdimësinë e investimeve kapitale në komunat përfituese.

Projektet dyvjeçare që vazhduan nga viti 2024 kanë qenë kryesisht në faza të avancuara të zbatimit në vitin 2025, duke siguruar vazhdimësinë e investimeve kapitale dhe shmangien e ndërprerjeve në realizimin e projekteve strategjike. Zbatimi i këtyre projekteve ka ndikuar drejtpërdrejt në planifikimin financiar dhe operacional të vitit 2025, duke kërkuar koordinim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunave përfituese.

Tabela 2: Projektet dyvjeçare në zbatim sipas PZHR 2024 për periudhën 2024–2025

Nr.	Komuna	Emri i projektit	Vlera sipas M.M. (€)
1	Prishtinë	Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë	120,000.00
2	Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	300,000.00
3	Mitrovicë	Renovimi i Qendrës Multifunkionale “Omni Sport” në Mitrovicë	150,000.00
4	Vushtrri	Udha e Gurit	80,000.00
5	Deçan	Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatore	120,000.00
6	Klinë	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II	130,000.00
7	Prizren	Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve “ESNAF”	184,160.00
8	Suharekë	Renovimi i “Urës së Tranzitit” dhe rregullimi i shtratit të lumit “Tophulla” - Segmenti 2.2	120,000.00
9	Mamushë	Kërkesë për ndërtimin e shtëpisë së kulturës me shumë qëllime	225,000.00
10	Shtime	Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)	100,000.00
11	Partesh	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit	100,000.00
12	Novobërdë	Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër	97,482.09
13	Kllokot	Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot	120,000.00
14	Rahovec	Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit	70,000.00
Totali i përgjithshëm:			1,916,642.09

Ecuria e zbatimit të projekteve kapitale në vitin 2025

Pasqyra e projekteve kapitale në zbatim gjatë vitit 2025

Në vitin 2025, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka mbështetur dhe monitoruar zbatimin e gjithsej 30 projekteve kapitale në komuna, përfshirë projektet e vazhduara nga viti 2024 dhe projektet e reja të përzgjedhura gjatë vitit 2025. Projektet janë shpërndarë në shtatë rajone zhvillimore dhe adresojnë fusha të ndryshme të zhvillimit lokal. Tabela në vijim paraqet pasqyrën e plotë të projekteve kapitale në zbatim gjatë vitit 2025, të ndara sipas rajoneve zhvillimore.

Tabela 3: Pasqyra e projekteve kapitale në zbatim gjatë vitit 2025 sipas rajoneve zhvillimore

Rajoni zhvillimor	Nr.	Komuna	Emri i projektit
01 - Qendër	1	Prishtinë	Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë
	2	Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt
	3	Podujeve	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik
Rajoni zhvillimor: 01 - Qendër - 3 projekte			
02 - Veri	4	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Qendrës Multifunkionale 'Omni Sport' në Mitrovicë
	5	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë
	6	Vushtrri	Udha e Gurit
	7	Vushtrri	Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës
	8	Zubin Potok	Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek liqeni I Zubin Potokut - Hapësirë për pushim, turizëm dhe komunitet
Rajoni zhvillimor: 02 - Veri - 5 projekte			
03 - Perëndim	9	Deçan	Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarë
	10	Klinë	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II
	11	Klinë	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan
Rajoni zhvillimor: 03 - Perëndim - 3 projekte			
04 - Jug	12	Prizren	Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve 'ESNAF'
	13	Prizren	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit
	14	Suharekë	Renovimi i 'Urës së Tranzitit' dhe rregullimi i shtratit të lumit 'Tophulla' - Segmenti 2.2
	15	Mamushë	Ndërtimi i shtëpisë së kulturës me shumë qëllime
	16	Mamushë	Ndërtimi i Shtëpise së Kulturës - Faza II
	17	Dragash	Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosavë

Rajoni zhvillimor: 04 - Jug - 6 projekte			
05 - Jug-lindje	18	Ferizaj	Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh
	19	Shtime	Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)
	20	Shtime	Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të
	21	Hani i Elezit	Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë
Rajoni zhvillimor: 05 - Jug-lindje - 4 projekte			
06 - Lindje	22	Gjilan	Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit
	23	Novobërdë	Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër
	24	Kllokot	Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot
	25	Kamenicë	Parku I Aventurave
	26	Partesh	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit
Rajoni zhvillimor: 06 - Lindje - 5 projekte			
07 - Jug-perëndim	27	Gjakovë	Renovimi i objektit të NPL "Stacionit të Autobusëve" - Gjakovë
	28	Rahovec	Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit
	29	Rahovec	Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve
	30	Junik	Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut
Rajoni zhvillimor: 07 - Jug-perëndim 4 projekte			

Shpërndarja financiare e projekteve kapitale sipas rajoneve zhvillimore

Shpërndarja financiare e investimeve kapitale paraqet mënyrën se si buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR), në kuadër të Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale, është alokuar ndërmjet rajoneve zhvillimore gjatë vitit 2025. Kjo analizë ofron një pasqyrë të qartë mbi peshën financiare të projekteve në secilin rajon zhvillimor dhe orientimin territorial të investimeve publike, duke reflektuar prioritetet zhvillimore dhe nevojat konkrete të komunave përfituese.

Tabela 4: Shpërndarja e financimeve të projekteve kapitale sipas rajoneve zhvillimore (2025)


Rajoni zhvillimor	Komuna	Emri i projektit	Vlera sipas M.M. (€)	Pjesëmarrja (%)
01 - Qendër	Prishtinë	Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë	120,000.00	
	Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	300,000.00	
	Podujeve	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik	50,000.00	

Rajoni zhvillimor: 01 - Qendër			470,000.00	12.37
02 - Veri	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Qendrës Multifunksionale 'Omni Sport' në Mitrovicë	150,000.00	
	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë	150,000.00	
	Vushtrri	Udha e Gurit	80,000.00	
	Vushtrri	Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës	100,000.00	
	Zubin Potok	Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek liqeni I Zubin Potokut - Hapësirë për pushim, turizëm dhe komunitet	80,000.00	
Rajoni zhvillimor: 02 - Veri			560,000.00	14.74
03 - Perëndim	Deçan	Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarë	120,000.00	
	Klinë	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II	130,000.00	
	Klinë	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan	100,000.00	
Rajoni zhvillimor: 03 - Perëndim			350,000.00	9.21
04 - Jug	Prizren	Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve 'ESNAF'	184,160.00	
	Prizren	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit	150,000.00	
	Suharekë	Renovimi i 'Urës së Tranzitit' dhe rregullimi i shtratit të lumit 'Tophulla' - Segmenti 2.2	120,000.00	
	Mamushë	Kërkesë për ndërtimin e shtëpisë së kulturës me shumë qëllime	225,000.00	
	Mamushë	Ndërtimi i Shtëpise së Kulturës - Faza II	225,000.00	
	Dragash	Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosovë	130,000.00	
Rajoni zhvillimor: 04 - Jug			1,034,160.00	27.22
05 - Jug-lindje	Ferizaj	Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh	100,000.00	
	Shtime	Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)	100,000.00	
	Shtime	Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të	150,000.00	
	Hani i Elezit	Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë	90,121.95	
Rajoni zhvillimor: 05 - Jug-lindje			440,121.95	11.58
06 - Lindje	Gjilan	Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit	219,569.32	
	Novobërdë	Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër	97,482.09	

	Kllokot	Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot	120,000.00	
	Kamenicë	Parku i Aventurave	50,000.00	
	Partesh	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit	100,000.00	
Rajoni zhvillimor: 06 - Lindje			587,051.41	15.45
07 - Jug - perëndim	Gjakovë	Renovimi i objektit të NPL "Stacionit të Autobusëve" - Gjakovë	100,000.00	
	Rahovec	Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit	70,000.00	
	Rahovec	Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve	98,000.00	
	Junik	Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut	90,000.00	
Rajoni zhvillimor: 07 - Jug-perëndim			358,000.00	9.42
Totali i përgjithshëm:			3,799,333.36	100.00

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 4, vlera e përgjithshme financiare e projekteve në zbatim gjatë vitit 2025, bazuar në Memorandumet e Mirëkuptimit, arrin në 3,799,333.36 euro. Kjo vlerë përfshin si projektet e vazhduara nga viti 2024, ashtu edhe projektet e reja të miratuara në vitin 2025. Figura 4 paraqet grafikisht shpërndarjen e financimeve për projektet e Masës 1 sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2025, duke përfshirë projektet e bartura nga viti 2024 dhe projektet e reja të përzgjedhura për këtë vit.

Figura 3: Shpërndarja e financimeve për projektet kapitale sipas rajoneve zhvillimore, në euro (2025)



Siç ilustron në grafik, rajoni zhvillimor Jug dominon në vlerën e investimeve, duke konfirmuar prioritetin e dhënë projekteve kapitale me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin socio-ekonomik dhe përmirësimin e infrastrukturës lokale.

Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja më e ulët e rajoneve Perëndim dhe Jugperëndim në financimin total sugjeron hapësirë për një balancim më të madh të investimeve në ciklet e ardhshme të financimit, në përputhje me objektivat e zhvillimit rajonal të balancuar. Grafiku mundëson krahasimin e drejtpërdrejtë të angazhimeve financiare ndërmjet rajoneve zhvillimore dhe shërben si bazë analitike për vlerësimin e prioriteteve territoriale të investimeve në kuadër të Masës 1.

Statusi i përgjithshëm i zbatimit të projekteve kapitale

Në këtë pjesë paraqitet një pasqyrë e statusit të zbatimit të projekteve të financuara në kuadër të Masës 1 – Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale. Të dhënat e mbledhura nga komunat dhe monitorimi i kryer nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) tregojnë nivelin e progresit financiar dhe realizimit të projekteve gjatë periudhës së raportimit.

Tabela 5: Statusi i zbatimit dhe progresi financiar i projekteve kapitale në vitin 2025

Nr.	Komuna	Emri i projektit	Vlera sipas M.M. (€)	Realizimi (€)	Përqindja e realizimit (%)
1	Prishtinë	Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë	120,000.00	120,000.00	100.00
2	Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	300,000.00	300,000.00	100.00
3	Podujeve	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik	50,000.00	50,000.00	100.00
4	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë	150,000.00	150,000.00	100.00
5	Vushtrri	Udha e Gurit	80,000.00	80,000.00	100.00
6	Deçan	Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarë	120,000.00	120,000.00	100.00
7	Klinë	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II	130,000.00	130,000.00	100.00
8	Klinë	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan	100,000.00	100,000.00	100.00
9	Prizren	Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve 'ESNAF'	184,160.00	184,160.00	100.00
10	Prizren	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit	150,000.00	150,000.00	100.00
11	Suharekë	Renovimi i 'Urës së Tranzitit' dhe rregullimi i shtratit të lumit 'Tophulla' - Segmenti 2.2	120,000.00	120,000.00	100.00
12	Mamushë	Kërkesë për ndërtimin e shtëpisë së kulturës me shumë qëllime	225,000.00	225,000.00	100.00

13	Mamusha	Ndërtimi i Shtëpise së Kulturës - Faza II	225,000.00	225,000.00	100.00
14	Dragash	Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosavë	130,000.00	130,000.00	100.00
15	Ferizaj	Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh	100,000.00	100,000.00	100.00
16	Klllokot	Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Klllokot	120,000.00	120,000.00	100.00
17	Rahovec	Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit	70,000.00	70,000.00	100.00
18	Rahovec	Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve	98,000.00	98,000.00	100.00
19	Junik	Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut	90,000.00	90,000.00	100.00
20	Shtime	Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)	100,000.00	99,802.00	99.80
21	Novobërdë	Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër	97,482.09	95,840.00	98.32
22	Hani Elezit	Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë	90,121.95	62,732.00	69.61
23	Kamenicë	Parku I Aventurave	50,000.00	32,700.00	65.40
24	Partesh	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit	100,000.00	48,070.36	48.07
25	Shtime	Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të	150,000.00	-	-
26	Mitrovicë	Renovimi i Qendrës Multifunkionale 'Omni Sport' në Mitrovicë	150,000.00	-	-
27	Gjakovë	Renovimi i objektit të NPL "Stacionit të Autobusëve" - Gjakovë	100,000.00	-	-
28	Vushtri	Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës	100,000.00	-	-
29	Gjilan	Rregullimi parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit	219,569.32	-	-
30	Zubin Potok	Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek liqeni I Zubin Potokut - Hapësirë për pushim, turizëm dhe komunitet	80,000.00	-	-
Totali i përgjithshëm:			3,799,333.36	2,901,304.36	76.36

Sipas Tabelës 4, shumica e projekteve të Masës 1 gjatë vitit 2025 kanë shënuar realizim të plotë financiar (100%), duke dëshmuar për një zbatim efikas dhe përmbushje të obligimeve kontraktuale nga ana e komunave përfituese. Këto projekte përfshijnë ndërhyrje në infrastrukturë publike, objekte kulturore, tregje komunale, projekte turistike dhe hapësira publike, të cilat janë përfunduar brenda afateve të përcaktuara.

Një pjesë e projekteve kanë shënuar realizim më të ulët, përkatësisht:

- Komuna e Parteshit – 48.07%
- Komuna e Kamenicës – 65.40%
- Komuna e Hanit të Elezit – 69.61%

Këto projekte ndodhen ende në faza të ndryshme të zbatimit, dhe niveli i realizimit financiar është ndikuar nga dinamika e punimeve, procedurat e prokurimit dhe faktorë të tjerë operacional.

Disa projekte ende nuk kanë filluar realizimin financiar, për arsye të ndryshme operative:

- Shtime – Ndërtimi i tregut të hapur, Faza III
- Mitrovicë – Renovimi i Qendrës Multifunkionale “Omni Sport”
- Gjakovë – Renovimi i objektit të NPL “Stacioni i Autobusëve”
- Vushtrri – Rrethoja e Çelikut, Ura e madhe e Sitnicës
- Gjiilan – Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane
- Zubin Potok – Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek liqeni

Në total, vlera e projekteve të Masës 1 arrin 3,799,333.36 €, ndërsa realizimi financiar deri në fund të periudhës raportuese është 2,901,304.36 euro, që përfaqëson një përqindje mesatare realizimi prej 76.36%. Kjo përqindje reflekton një progres të konsiderueshëm të zbatimit, duke pasur parasysh se disa projekte janë dyvjeçare ose ndodhen ende në fazat fillestare të realizimit.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një nivel të kënaqshëm të zbatimit të projekteve të Masës 1, me realizimin e plotë të shumicës së tyre dhe angazhimin e vazhdueshëm të MZHR-së për monitorimin dhe mbështetjen e projekteve që janë ende në proces realizimi.

Arsyet e mosrealizimit

Mosrealizimi i disa projekteve kapitale gjatë vitit 2025 është rezultat i një sërë faktorësh, të lidhur kryesisht me vonesat dhe parregullsitë në procedurat e prokurimit, mungesën e përmbushjes së kushteve kontraktuale nga ana e komunave, si dhe vendimeve institucionale të ndërmarra për të garantuar respektimin e kuadrit ligjor në fuqi. Këta faktorë kanë ndikuar drejtpërdrejt në pamundësinë e fillimit ose vazhdimin e zbatimit të projekteve brenda periudhës së raportimit.

Tabela 6: Analiza e faktorëve pengues në realizimin e projekteve kapitale

FAKTORI	PËRSHKRIMI	RAST KONKRET
PROBLEMET ME PROCEDURAT E PROKURIMIT	Vonesa në përfundimin e procedurave të prokurimit dhe tenderimit kanë pamundësuar nënshkrimin e kontratave dhe fillimin e zbatimit të projekteve brenda afateve të planifikuara.	Në projektet <i>Renovimi i objektit të NPL "Stacioni i Autobusëve"</i> në Gjakovë, <i>"Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të"</i> dhe <i>Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit të Gjilanit</i> , procedurat e prokurimit nuk janë përmbyllur me kohë, duke penguar realizimin e tyre gjatë vitit 2025.
MOSPËRMBUSHJA E KUSHTEVE KONTRAKTUALE	Mospajtimi për kushtet e nënshkrimit të kontratave, veçanërisht lidhur me zotimin financiar shumëvjeçar, ka çuar në mosfillimin e projekteve.	Në projektin <i>Renovimi i Qendrës Multifunkionale "Omni Sport"</i> në Mitrovicë, autoritetet komunale nuk kanë pranuar nënshkrimin e kontratës pa zotim të plotë financiar për dy vite, gjë që nuk ka qenë e mundur për shkak të kufizimeve të sistemit të prokurimit.
SHKELJE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT	Mosrespektimi i rregullave dhe rekomandimeve ligjore në procesin e prokurimit ka rezultuar në masa institucionale, përfshirë anulimin e marrëveshjes.	Për projektin <i>Rrethoja e Çelikut – Ura e madhe e Sitnicës në Vushtrri</i> , Marrëveshja e Mirëkuptimit është anuluar nga MZHR për shkak të shkeljeve të vazhdueshme në procedurat e prokurimit nga ana e komunës, pavarësisht vërejtjeve të dhëna.
HEQJA DORË NGA PROCEDURAT	Mungesa e angazhimit institucional në përmbylljen e procedurave të prokurimit ka ndikuar në mosrealizimin e projekteve.	Në projektin <i>Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek Liqeni i Zubin Potokut</i> , autoritetet komunale kanë hequr dorë nga mundësia e përfundimit të procedurave të prokurimit, duke pamundësuar realizimin e projektit.

Nga analiza e faktorëve të mësipërm, rezulton se sfidat në realizimin e projekteve gjatë vitit 2025 lidhen kryesisht me menaxhimin e proceseve të prokurimit dhe respektimin e kuadrit ligjor përkatës. Vonesat procedurale, mospërbushja e kushteve kontraktuale dhe shkeljet në proceset e tenderimit kanë ndikuar ndjeshëm në zbatimin e investimeve të planifikuara.

Për të shmangur situata të ngjashme në të ardhmen, është e domosdoshme forcimi i kapaciteteve administrative në nivel lokal, rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe respektimi rigorozi i procedurave të prokurimit. Gjithashtu, një planifikim më i hershëm dhe monitorim më i rreptë i proceseve do të kontribuonin në realizimin me kohë dhe efektivitet të projekteve kapitale në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal.

Projektet që vazhdojnë realizimin në vitin 2026

Në vijim paraqitet Tabela 6, e cila përmbledh projektet që kanë filluar në vitin 2025 dhe do të vazhdojnë realizimin gjatë vitit 2026, në kuadër të zbatimit të Masës 1, 2025. Këto projekte

janë të shpërndara në rajone të ndryshme zhvillimore dhe përfshijnë investime në infrastrukturë publike, sportive, turistike dhe urbane, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal. Financimi për vitin 2026 është planifikuar në përputhje me Marrëveshjet e Mirëkuptimit (M.M.), duke siguruar vazhdimësinë e punimeve dhe përfundimin me sukses të projekteve prioritare, me një vlerë të përgjithshme prej 1,650,000.00 €¹.

Tabela 7: Projektet kapitale që vazhdojnë realizimin e në vitin 2026

Nr.	Rajoni zhvillimor	Komuna	Emri i projektit	Vlera sipas M.M. për 2026 (€)
1	01 - Qender	Podujevë	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik	200,000.00
2	02 - Veri	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë	200,000.00
3	04 - Jug	Prizren	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalane e Prizrenit	200,000.00
4	05 - Jug-lindje	Ferizaj	Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh	200,000.00
5		Shtime	Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të	272,000.00
6	06 - Lindje	Gjilan	Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit	200,000.00
7	07 - Jug-perëndim	Gjakovë	Renovimi i objektit të NPL "Stacionit të Autobusëve" - Gjakovë	150,000.00
8		Rahovec	Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve	100,000.00
9		Junik	Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik	128,000.00
Totali i përgjithshëm:				1,650,000.00

¹ Numri i projekteve që vazhdojnë realizimin në vitin 2026 është 9 (dhe jo 10), ndërsa vlera totale është 1.65 milion € (dhe jo 1.7 milion €), për shkak se projekti përfitues "Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës në Vushtrri" nga Komuna e Vushtrrisë (projekt dyvjeçar, me vlerë 100,000 € në vitin 2025 dhe 50,000 € në vitin 2026) nuk vazhdon realizimin. Marrëveshja e Mirëkuptimit për këtë projekt është anuluar nga MZHR si pasojë e shkeljeve në procedurat e prokurimit nga ana e komunës, pavarësisht vërejtjeve të përsëritura institucionale.

Përfundimi

Zbatimi i Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale gjatë vitit 2025 dëshmon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të projekteve dhe për një menaxhim të qëndrueshëm të investimeve publike në nivel lokal dhe rajonal. Të dhënat e paraqitura në këtë raport tregojnë se shumica e projekteve janë realizuar me sukses dhe brenda afateve të planifikuara, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës publike, shërbimeve komunale dhe kushteve të jetesës për qytetarët.

Me një vlerë totale të projekteve prej 3,799,333.36 euro dhe një nivel realizimi financiar prej 76.36%, Masë 1 ka pasur një ndikim të dukshëm në zhvillimin socio-ekonomik të komunave përfituese. Realizimi i plotë i shumicës së projekteve konfirmon kapacitetin e komunave dhe rolin mbështetës të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të investimeve kapitale.

Megjithëse disa projekte kanë shënuar vonesa ose nuk kanë filluar realizimin gjatë vitit 2025, analizat e paraqitura tregojnë se këto raste lidhen kryesisht me sfida procedurale dhe administrative, veçanërisht në fushën e prokurimit publik. Masat e ndërmarra nga MZHR për respektimin e kuadrit ligjor dhe sigurimin e transparencës kontribuojnë në mbrojtjen e interesit publik dhe në rritjen e cilësisë së investimeve.

Vazhdimi i projekteve dyvjeçare në vitin 2026 dhe planifikimi i financimit për këtë periudhë sigurojnë vazhdimësinë e investimeve dhe përfundimin me sukses të ndërhyrjeve prioritare. Në këtë kontekst, Masë 1 mbetet një instrument kyç për zhvillimin rajonal të balancuar dhe për forcimin e kapaciteteve zhvillimore të komunave në Republikën e Kosovës.

Në përfundim, raporti konfirmon rëndësinë e planifikimit të hershëm, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe monitorimit të vazhdueshëm si elemente thelbësore për realizimin efektiv të projekteve kapitale dhe për arritjen e objektivave të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

ANEKS 1 Rajoni zhvillimor: Qendër

Tabela 8: Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë

Komuna	PRISHTINË
Titulli i projektit	"Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë"
Përshkrimi i projektit	Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe Ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	11.03.2024 (Aneks 07.02.2025)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	240,000.00 € (120,00.00 € (2024 e bartur) + 120,000.00 € (2025 e aprovuar))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	140,665.15 € (2025)
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	24.02.2025 – 365,000.00 €
Emri i Kontraktuesit	DACHGroup SH.P.K. ; NIVA Construction SH.P.K. ; HARST Group SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	120,000.00 €




Tabela 9: Ndërtimi i tregut të gjelbërt

Komuna	PODUJEVË
Titulli i projektit	“Ndërtimi i tregut të gjelbërt”
Përshkrimi i projektit	Ndërtimi i tregut të gjelbërt me sipërfaqe 3,108.55 m2.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.03.2024 (Aneks 10.12.2024)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	300,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	300,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	03.10.2024 – 1,440,787.30 €
Emri i Kontraktuesit	EING COM SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	300,000.00 €





Tabela 10: Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik

Komuna	PODUJEVË
Titulli i projektit	“Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik”
Përshkrimi i projektit	Ndërtimi i objektit sportiv të mbyllur, të dimensioneve standarde për zhvillimin e sporteve si basketbolli, hendbolli, volejboli, futbolli i vogël, etj.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	250,000.00 € (50,000.00 € (2025) + 200,000.00 € (2026))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	100,000.00 € (50,000.00 € (2025) + 50,000.00 € (2026))
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	04.09.2025 – 384,996.79 €
Emri i Kontraktuesit	Konstruktori Ing.1969 SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	50,000.00 €



ANEKS 2 Rajoni zhvillimor: Veri

Tabela 11: Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë

Komuna	MITROVICË
Titulli i projektit	"Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë"
Përshkrimi projektit	Renovimi i tërësishëm i të gjitha hapësirave duke përfshirë suvatimin, lyerjen, sistemin e ri të ndriçimit, trajtimin e dyshemesë, shkalleve, tualeteve, etj.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	350,000.00 € (150,000.00 € (2025) + 200,000.00 € (2026))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	180,175.00 € (60,000.00 € (2025) + 120,175.00 (2026))
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	26.08.2025 - 529,902.01 €
Emri i Kontraktuesit	Dach Group SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	150,000.00 €





Tabela 12: Udha e Gurit

Komuna	VUSHTRRI
Titulli i projektit	"Udha e Gurit"
Përshkrimi projektit	Hapja e Urës së Vjetër të Gurit për qytetarët, ndërtimin e shtegut të ri për këmbësor, duke targetuar grupe të ndryshme.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.03.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	80,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	59,418.84 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	31.07.2024 – 359,717.22 €
Emri i Kontraktuesit	"Rinesa" sh.p.k. & "Limit Project" sh.p.k & "Ideal Partners" shpk & "Lindart" shpk
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	80,000.00 €



ANEKS 3 Rajoni zhvillimor: Perëndim

Tabela 13: Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatare

Komuna	DEÇAN
Titulli i projektit	"Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatare"
Përshkrimi projektit	Ndërtimi i një ZipLine dhe shtallë për kuaj, duke ofruar një kalim për vizitorët nga rruga drejt bjeshkëve të Nemuna.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	06.02.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	120,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	153,863.64 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	22.08.2024 – 413,863.34 €
Emri i Kontraktuesit	HIDRO PROJECT SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	120,000.00 €
	


Tabela 14: Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II

Komuna	KLINË
Titulli i projektit	"Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II"
Përshkrimi i projektit	Rregullimi i trotuarit dhe shtigjeve për biçikleta në anën e djathtë të rrugës Klinë-Pejë-Prishtinë, me infrastrukturën përkatëse.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	31.01.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	130,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	91,400.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	04.09.2024 – 694,909.00 €
Emri i Kontraktuesit	MIRUSHA COMPANY SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	130,000.00 €



Tabela 15: Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan

Komuna	KLINË
Titulli i projektit	"Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan"
Përshkrimi i projektit	Rregullimi i trotuarit me ndriçim për të mundësuar qarkullim të sigurtë në funksion të një qasje sa më të lehtë për gjithë banorët.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	100,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	260,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	20.08.2025 – 304,444.44 €
Emri i Kontraktuesit	CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM; N.N.P. ATC COM SH.P.K.;
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	100,000.00 €



ANEKS 4 Rajoni zhvillimor: Jug

Tabela 16: Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve "ESNAF"

Komuna	Prizren
Titulli i projektit	"Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve "ESNAF""
Përshkrimi projektit	Ndërtimi i objektit të ri me gjithsej 672 m2, me etazhitet B+P+1+Nk, ku do të krijohen hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të zejtarëve.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.03.2024 (Aneks 07.02.2025)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	184,160 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	86,040.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	18.02.2025 – 375,375.00 €
Emri i Kontraktuesit	TRIANGLE SH.P.K.; NDT Kontrolli SH.P.K.;
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	184,160.00 €




Tabela 17: Zhvillimi i shtigjeve per turizem, kulture dhe rekreacion ne Kalane e Prizrenit

Komuna	PRIZREN
Titulli i projektit	"Zhvillimi i shtigjeve per turizem, kulture dhe rekreacion ne Kalane e Prizrenit "
Përshkrimi projektit	Ndërhyrje për përmirësimin e aksesit turistik, rrugë biçikletash, shtigje këmbësorësh, etj dhe që përputhet me qëllimet dhe interesatv e qytetareve.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	350,000.00 € (150,000.00 (2025) + 200,000.00 € (2026))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	50,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	29.08.2025 – 399,876.00 €
Emri i Kontraktuesit	Zline Company SH.P.K, Valdrini sh.p.k, AAB CONSTRUCTION SH.P.K. FORTESA SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	150,000.00 €



Tabela 18: Renovimi i “Urës së Tranzitit” dhe rregullimi i shtratit të lumit “Tophulla” - Segmenti 2.2

Komuna	SUHAREKË
Titulli i projektit	"Renovimi i “Urës së Tranzitit” dhe rregullimi i shtratit të lumit “Tophulla” - Segmenti 2.2"
Përshkrimi i projektit	Renovimi i urës dhe shtratit të lumit, në murin mbrojtës nga betoni me gjerësi 4m, gjerësia 0.4m, shputa e murit me gjerësi 2.60m dhe trashësi 0.50m.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	07.02.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	120,000.00 € (2025)
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	56,134.01 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	06.12.2024 – 331,870.24 €
Emri i Kontraktuesit	DIA CONSULTING SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	120,000.00 €



Tabela 19: Ndërtimi i shtëpisë së kulturës me shumë qëllime

Komuna	MAMUSHË
Titulli i projektit	"Ndërtimi i shtëpisë së kulturës me shumë qëllime"
Përshkrimi i projektit	Ndërtimi i Qendrë Kulturore, e cila do të shërbejë për plotësimin e nevojave të komunitetit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	14.03.2024 (Aneks 12.08.2025)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	225,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	100,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	28.08.2024 – 1,923,423.00 €
Emri i Kontraktuesit	TRIANGLE SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	225,000.00 €





Tabela 20: Ndërtimi i Shtëpise së Kulturës - Faza II

Komuna	MAMUSHË
Titulli i projektit	"Ndërtimi i Shtëpise së Kulturës - Faza II"
Përshkrimi i projektit	Ndërtimi i Qendrës Kulturore, e cila do të shërbejë për plotësimin e nevojave të komunitetit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	225,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	75,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	28.08.2024 – 1,923,423.00 €
Emri i Kontraktuesit	TRIANGLE SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	225,000.00 €





Tabela 21: Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosovë

Komuna	DRAGASH
Titulli i projektit	"Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosovë"
Përshkrimi i projektit	Riparimi i amfiteatrit në Bellobrad, ku do të zhvillohen punime ndërtimore të tipit të hapur për ta funksionalizuar këtë objekt.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	130,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	20,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	01.09.2025 – 139,305.10 €
Emri i Kontraktuesit	ARMIRING SH.P.K.; ENG GEO GROUP SH.P.K;
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	130,000.00 €



ANEKS 5 Rajoni zhvillimor: Jug-lindje

Tabela 22: Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh

Komuna	FERIZAJ
Titulli i projektit	"Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh"
Përshkrimi projektit	Projekti synon zhvillimin dhe transformimin e një hapësire ekzistuese në fshatin Varosh në një zonë të integruar rekreative dhe turistike.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	300,000.00 € (100,000.00 (2025) + 200,000.00 (2026))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	22,392.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	17.09.2025 – 359,756.53 €
Emri i Kontraktuesit	Berisha Company SH.A.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	100,000.00 €



Tabela 23: Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - Komuna e Shtimës (Faza II)

Komuna	SHTIME
Titulli i projektit	"Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - Komuna e Shtimës (Faza II)"
Përshkrimi projektit	
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	08.02.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	100,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	40,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	07.08.2024 – 299,584.00 €
Emri i Kontraktuesit	XHEMSHIR SEJDIJA B.I.; TALA ENGINEERING SH.P.K.;
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	99,802.00 €



Tabela 24: Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë

Komuna	HANI I ELEZIT
Titulli i projektit	"Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë"
Përshkrimi i projektit	Parku do të përfshijë rregullimin e hapësirës së lirë në afërsi të gjelbërimit të lartë (pishave) në të cilën do të integrohen edhe aktivitete të tjera.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.06.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	90,121.95 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	10,013.55 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	27.11.2025 – 78,145.00 €
Emri i Kontraktuesit	HIDRO PROJECT SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	62,732.00 €



Tabela 25: Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër

Komuna	NOVOBËRD
Titulli i projektit	"Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër"
Përshkrimi projektit	Ndërtimi i rrugës me gjerësi 4 metra, gjërsia me bankina 0.50 m dhe gjërsia e bazës së rrugës është 5 metra.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	25.07.2024 (Aneks 07.02.2025)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	97,482.09 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	7,000.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	02.12.2024 – 104,482.09 €
Emri i Kontraktuesit	Knn Project SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	95,840.00 €




Tabela 26: Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot

Komuna	KLLOKOT
Titulli i projektit	"Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot"
Përshkrimi i projektit	Projekti parasheh parandalimin e mundësisë së përhapjes së infeksioneve dhe evidentimin e mundësisë së vërshimeve për qytetin e Kllokotit.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	26.03.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	120,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	32,252.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	23.10.2024 – 364,019.78 €
Emri i Kontraktuesit	Berisha Company SH.A.; DIAMANTI SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	120,000.00 €



Tabela 27: Parku i Aventurave

Komuna	KAMENICË
Titulli i projektit	"Parku i Aventurave"
Përshkrimi i projektit	Ky projekt ka karakteristik kryesore zhvillimin e zonës turistike, e cila do të transformohet në pike turistike, me shtigje për çiklist dhe stacione për pushim
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	11.03.2024 (Aneks 07.02.2025)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	50,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	200,000.00 € (30,000.00 (2025) + 170,000.00 (2026))
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	24.07.2025 – 299,487.00 €
Emri i Kontraktuesit	Dua arch SH.P.K.; Dashmir Jashari B.I.; TRIANGLE SH.P.K.;
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	32,700.00 €



Tabela 28: Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit

Komuna	PARTESH
Titulli i projektit	"Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit"
Përshkrimi i projektit	Rregullimi i shtratit të lumit në gjatësi prej 348 metrash do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së të gjithë qytetarëve.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	28.02.2024 (Aneks 07.02.2025)
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	180,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	31,275.30 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	04.11.2025 – 207,005.78 €
Emri i Kontraktuesit	Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	48,070.35 €



Tabela 29: Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit

Komuna	RAHOVEC
Titulli i projektit	"Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit"
Përshkrimi i projektit	
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	26.02.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	70,000.00 €
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	70,117.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	29.07.2024 – 319,993.00 €
Emri i Kontraktuesit	Three Group SH.P.K.; N.P.T. Bamirs
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	70,000.00 €



Tabela 30: Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve

Komuna	RAHOVEC
Titulli i projektit	"Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve"
Përshkrimi i projektit	Projekti synon të përmirësojë cilësinë e jetës së banorëve përmes investimeve në ndërtimin dhe rregullimin e rrugëve lokale.
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	01.07.2025
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	198,000.00 € (98,000.00 (2025) + 100,000.00 (2026))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	99,908.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	02.09.2025 – 297,908.00 €
Emri i Kontraktuesit	AGE group SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K.; SELMANS NETWORK SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	98,000.00 €





Tabela 31: Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut

Komuna	JUNIK
Titulli i projektit	"Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut"
Përshkrimi i projektit	
<u>Përgatitja dhe Faza e Aprovimit</u>	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	24.06.2024
Totali i vlerës së zotuar nga MZHR	226,000.00 € (90,000.00 (2025) + 128,000.00 (2026))
Vlera e bashkëfinancimit nga komuna	170,339.00 €
<u>Kontrata</u>	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga:	Komuna
Data e nënshkrimit dhe vlera e kontratës	23.07.2025 – 336,291.00 €
Emri i Kontraktuesit	JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K.
<u>Pagesat</u>	
Vlerat e pagesës nga MZHR	90,000.00 €

